



REPUBLIKA E KOSOVËS - РПУБЛИКА КОСОВА - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - Vlada Kosova - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive
Nr./Br./No. 241/9
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 2+2
Data/Datum/Date: 30/03/2016
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm -Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary
General

Datë: 30.03.2016
Ref. ZSP.264/16
Nr.180

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, dt. 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, nxjerrë:

V E N D I M

Për pezullimin e përkohëshëm të Autorizimit për Peshkim Sportiv Rekreativ me
Ref.ZSP.11/06 të dt. 15.01.2016,

1. Pezullohet përkohësisht Autorizimi për Peshkim Sportiv Rekreativ me Ref.ZSP.11.06 të dt. 15.01.2016.
2. Pezullimi i autorizimit nga pika 1 e këtij vendimi, bëhet për shkak keq menaxhimit të Përfaqësuesit të Autorizuar në Federatën e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ të Kosovës (PPSRK).
3. Pezullimi i autorizimit bëhet deri në marrjen e një vendimi tjetër.
4. Obligohet Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve dhe Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke marrë për bazë kërkesën e Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregjeve me Ref.04.3-81/16 të

dt.30.03.2016 me te cilin propozon pezullimin e përkohshëm të autorizimit për shkak keq menaxhimit të autorizimit nga përfaqësuesi i autorizuar në Federatën e Peshkimit Sportiv Rekreativ të Kosovës, me te cilin vërtetohet se nga organet kompetente gjyqësore ka dyshime të bazuara për hetime të keqpërdorimit, falsifikimit të dokumentit zyrtar të lëshuar nga Ministria, si dhe për shkak rrethanave të krijuara në teren të cilat për momentin janë të pa e vështjeme, vendosi që të merr vendim për pezullimin e përkohshëm të autorizimit deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Obligohet Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve dhe Federata e Peskatarëve Sportiv Rekreativ të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.

Ankesa nuk e ndal ekzekutimin e këtij pezullimi të përkohshëm të autorizimit.




Kapllan Halimi

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Vendimi i dërgohet:

- *Federatës së Peshkimit Sportiv Rekreativ të Kosovës,*
- *Kabinetit të Ministrit,*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,*
- *Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregjeve, dhe*
- *Arkivit.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë /Department Poljoprivrednih Politika i
Trgovine/Department of Agriculture Policy and Trade

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	04.3-81/16				
PËR/ZA/TO:	z. Kapllan Halimi, Sekretar i Përgjithshëm i MBPZHR-së				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Isuf Cikaqi, Drejtor i Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregtisë				
NGA/OD/FROM:	Arsim Memaj, Shef i Divizionit të Prodhimtarisë Blegtorale				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë				
Nr. i zyrës:	111	Lokacioni:	Prishtinë	Data:	
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	30.03.2016
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuar z. Halimi, Sekretar i Përgjithshëm
Mbështetur në zhvillimet në Kryesinë e Federatës së Peshkatarëve Rekreativë Sportivë (FPRSK), si rezultat i së cilës kemi 2 (dy) kryesi të cilat nuk njohin njëra tjetrën, keqpërdorimin e Autorizimit të datës 15.01.2016 me Nr. ZSP 11/16 , zhvillime këto për të cilat jeni të informuar

kërkoj nga Ju që të autorizoni Departamentin ligjorë që të merr vendim për pezullimin e përkohshëm të Autorizimit të lartpërmendur.

Gjithashtu propozoj që të pezullohen edhe Lejet për peshkatarët Rekreativë-sportivë dhe ID e të ashtuquajtur "Task Forca" të lëshuar pas datës 04.02.2016.

Propozimin për pezullim nga sa u tha më lartë e bazojom në:

1. Mosmarrëveshjet në mes të 2 (dy) kryesive që nuk njohin njëra tjetrën dhe nuk kanë bashkëpunim;
2. Paqartësi të shkaktuara në anëtarësinë e shoqatave lokale të peshkatarëve rekreativë - sportivë të integruara në FPRSK për lëshimin e Lejeve të peshkimit dhe
3. Keqpërdorimit të Autorizimit dhe logos zyrtare të MBPZHR.

Pezullimi si masë propozojm të jetë valid deri në zgjedhjen e çështjeve kontestuese në mes kryesive të FPRSK-së dhe keqpërdorimit të Autorizimit dhe logos zyrtare të MBPZHR. Për trajtimin e këtyre problemeve propozoj që MBPZHR të inicioj një takim të përbashkët me kryesitë e FPRSK.

Me respekt